



Pyetje të shpeshta për Mbrojtjen Ndërkombëtare



Cilët kanë të drejtë për azil/mbrojtje ndërkombëtare?

Shteti grek mbron (me ofrimin e azilit, statusin e refugjatit - mbrojtje ndërkombëtare) nënshtetas vendi të tretë ose pa nënshtetësi, të cilët ndiqen për arsye race, feje, kombësie, pjesëmarrje në grup të veçantë social ose bindjesh politike, ose për arsye se rrezikohen të pësojnë dëmtim të rëndë (fizik) në vendin e origjinës ose të vendqëndrimit të tyre të mëparshëm, sidomos pasi rrezikohen me dënim me vdekje ose ekzekutim, me tortura ose trajtim çnjerëzor ose poshtërues ose rrezikohet jeta ose integriteti i tyre fizik për arsye të konflikteve ndërkombëtare ose civile.



Si bëj kërkesë për azil ?

Mund të bëni kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare/azil ndërsa ndodheni në Qendrat e Pritjes dhe Identifikimit. Nëse kërkon, personeli i Qendrës së Pritjes dhe Identifikimit do t'ju drejtojë në njësinë kompetente të Shërbimit të Azilit për kërkesën tuaj.

Përndryshe mund të regjistroni kërkesën tuaj edhe në mënyrë elektronike në aplikacionin e mëposhtëm elektronik.

<https://apps.migration.gov.gr/selfregistration/login>



Duhet të paguaj për të bërë kërkesën?

Jo, aksesimi në procedurën e mbrojtjes ndërkombëtare është i lirë dhe falas.

 Mund të bëj kërkesë edhe për bashkëshorten dhe për fëmijët e mi?

Mund të depozitoni kërkesë edhe për anëtarët e familjes suaj nëse ata ndodhen me ju në Greqi dhe e dëshirojnë.

 Si vendos përgjegjësi i çështjes sime nëse do të marr azil ose jo?

Përgjegjësi merr vendim mbi kërkesën duke bashkëvlerësuar deklaratimet tuaja gjatë intervistës suaj personale, të dhënat që keni depozituar për të mbështetur çështjen tuaj, informacionet përkatëse për vendin tuaj të origjinës dhe të gjitha të dhënat që përfshihen në dosjen tuaj administrative.

 Mund të udhëtoj pasi të kem bërë kërkesë për azil dhe jam në pritje të përgjigjes?

Jo, si kërkues për mbrojtje ndërkombëtare **nuk** mund të udhëtoni jashtë Greqisë. Me perjashtim të rrethanave specifike kur paraqiten arsye serioze humanitare të cilat diktojnë praninë tuaj në shtet tjetër si p.sh. arsye serioze shëndetësore të vërtetuara me fakte. Do të duhet të bëni kërkesë pranë Shërbimit me qëllim lëshimin e një dokumenti udhëtimi. Nëse largoheni nga vendi pa informuar Shërbimin e Azilit, kërkesa juaj do të do të refuzohet.

 Duhet të sjell përkthyes në intervistë- çfarë ndodh nëse nuk di anglisht?

Shërbimi i Azilit do të kujdeset që të ketë përkthyes që flet gjuhën tuaj ose një gjuhë që ju kuptoni në çdo transaksion tuajin me Shërbimin.

 Si mund të mësoj se në cilën fazë ndodhet kërkesa ime.

Do të duhet të paraqiteni personalisht ju ose avokati juaj i autorizuar pranë Shërbimit , pasi nuk jepen informacione për çështjet nëpërmjet telefonit.

Ndërkohë, për arsye të fluksit të madh të personave të cilëve u shërbehet përditë ju rekomandojmë të vini kur afrohet data e skadencës së kartës suaj(ΔΑΔΠ Karta e Kërkuesit të Mbrojtjes Ndërkombëtare) për rinovim, kështu që do të informoheni në lidhje me ecurinë e çështjes tuaj.

 Mund të bëj kërkesë edhe nëse ndodhem në Greqi në mënyrë të paligjshme/të parregullt?



Po, fakti që hytë në vend në mënyrë të paligjshme/të parregullt nuk ndikon aksesin në procedurën dhe shqyrtimin e kërkesës suaj, mjafton të bëni kërkesë brenda një kohe të shkurtër nga hyrja në vend. Nëse keni hyrë ne Greqi në mënyrë të paligjshme/të parregullt do të qendroni detyrimisht në Qendër Pritjeje dhe Identifikimi dhe do të bëni kërkesën tuaj për Mbrojtje Ndërkombëtare në Njësi të Shërbimit të Azilit që funksionon brenda Qendrës.



Mund të bëj kërkesë nëse jam i mitur?

Po. Nëse jeni nën pesëmbëdhjetë (15) vjeç, kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare duhet ta depozitoni prindi juaj ose personi i rritur që është përcaktuar përgjegjes për kujdesin tuaj, ose nëse jeni i pashoqëruar përfaqësuesi që ju është caktuar. Nëse jeni mbi pesëmbëdhjetë (15) vjeç, mund të depozitoni personalisht kërkesën tuaj. Nëse jeni i mitur i pashoqëruar, Autoritetet do t'ju caktojnë një kujdestar që do të kujdeset për mbrojtjen tuaj dhe akomodimin tuaj në një mjedis të përshtatshëm për të mitur dhe do t'ju ndihmojë me kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare.



Mund të jetë dikush prezent bashkë me mua të më ndihmojë në intervistën time?

Në intervistë mund të shoqëroheni nga avokati juaj i autorizuar, nga një mjek, një punonjës social ose një psikolog.



Mund të kem akses në përkujdesjen mjekësore ndërsa pres rezultatin e kërkesës sime?

Po. Për të pasur akses në përkujdesjen farmaceutiko-mjekësore dhe spitalore,

ju mund të pajiseni me Numër të Përkohshëm Sigurimi dhe Kujdesi

Shëndetësor për të Huajt (PAAYPA) sapo të bëni kërkesën tuaj.



Mund të udhëtoj pasi të marr azil (të miratohet kërkesa ime)?

Në rast se ju jepet statusi i refugjatit mund të kërkonit lëshimin e një dokumenti udhëtimi (TDV) në të cilin përcaktohet përkufizim lëvizjeje drejt vendit tuaj të origjinës. Në rast se ju jepet mbrojtje plotësuese, mund të bëni kërkesë gjithashtu për lëshimin e dokumentit të udhëtimit, por do t'ju jepet vetëm nëse Shërbimi gjykon se egziston pamundësi për të nxjerrë pasaportë kombëtare nga autoritetet e shtetit tuaj.



Të dhënat personale që jap në intervistën time/kërkesën time, janë të mbrojtura?

Po , të gjithë të pranishmit janë të lidhur me detyrimin e konfidencialitetit. Shërbimi i Azilit angazhohet të mos japë asnjë informacion mbi kërkesën tuaj në autoritetet e shtetit tuaj, por mund të bëjë të ditur të dhënat në autoritete të tjera greke



Ku mund të gjej ligjin për azil në Greqi?

Ligjet 4686/2020, 4636/2019, 4825/2021 mbi mbrojtjen ndërkombëtare janë publikuar në gjuhën greke në faqen e internetit të Shërbimit të Azilit



Cili është ndryshimi ndërmjet azilkërkuesit dhe refugjatit që i është njohur ky status – përsa i përket të drejtave?

Azilkërkuesi është zotërues i Kartës së Kërkuesit të Mbrojtjes Ndërkombëtare që i jep të drejtën të qëndrojë në mënyrë të ligjshme në vend dhe gëzon të drejtat që i garantojnë transaksionet e nevojshme deri sa të dalë vendimi i kërkesës së tij. Përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare dhe zotërues të lejes së qëndrimit gëzojnë të drejta të njëjta me ato që gëzojnë nënshtetasit Grekë.



Çfarë ndodh nëse kërkesa refuzohet?

Ju mund të kundërshtoni vendimin falas kundrejt një organi të pavarur të shkallës së dytë, Autoritetit të Apelit, brenda afatit që do të përmendet në vendimin tuaj. Gjithashtu keni akses në ndihmën juridike falas në këtë fazë. Nëse kërkesa juaj për mbrojtje ndërkombëtare si përfundim refuzohet, do të zbatohet vendimi i largimit nga vendi.



Sa kohë zgjat procedura e shqyrtimit të kërkesës sime deri sa të dalë përgjigja përfundimtare?

Në total, shqyrtimi i kërkesës suaj mund të zgjasë nga njëzet (20) ditë deri në gjashtë (6) muaj, sipas rastit.